


TË DREJTAT DHE NEVOJAT ARSIMORE TË ADOLESHENTËVE DHE FËMIJËVE TË SËMURË

1. Çdo fëmijë, i sëmurë apo adoleshent, ka të drejtën e shkollimit në spital ose në shtëpi, edhe kur trajtohet në një vend tjetër, përveç vendit të tij.
2. Qëllimi i studimit për fëmijët e sëmurë dhe adoleshentët është vazhdimi i edukimit, duke i dhënë mundësinë atyre të mbajnë rolin e nxënësit.
3. Spitali- shkollë krijon një komunitet fëmijësh dhe adoleshentësh dhe normalizon jetën e përditshme. Edukimi në spital duhet të organizohet si klasë, grup ose si mësim individual si dhe gjithashtu në një mësimdhënie edhe më të ngushtë në anë të shtratit.
4. Shkollimi spitalor apo në shtëpi duhet të përshtatet ndaj nevojave dhe aftësive të fëmijës ose të adoleshentit në bashkëpunim me shkollën e vendit të banimit.
5. Mjedisi i të mësuarit dhe lehtësirat duhet të përshtaten me nevojat e fëmijës së sëmurë dhe adoleshentëve, dhe komunikimi teknologjik duhet të përdoret si mjet për të parandaluar izolimin.
6. Duhet të përdoret një varietet metodash mësimore dhe burimesh. Përmbajtja përfshin më tepër sesa mësimi formal duke qenë se përmban edhe lëndë që lidhen me nevojat e vecanta që lindin nga sëmundja dhe shtrimi në spital.
7. Mësuesit e shkollimit në spital dhe shtëpi duhet të jenë plotësisht të kualifikuar dhe duhet të përfshihen në trajnime të mëtejshme.
8. Mësuesit e fëmijëve të sëmurë dhe adoleshentëve janë anëtarë të plotë të ekipit të kujdesit multi-disiplinor dhe janë lidhja mes fëmijës së shtruar në spital dhe shkollës së vendlindjes.
9. Prindërit duhet të informohen mbi të drejtën e shkollimit dhe programit të edukimit për fëmijën e sëmurë ose adoleshentit. Ato duhet të njihen si partner të përgjegjshëm dhe aktiv.
10. Integriteti i fëmijës ose adoleshentit duhet të respektohet duke përfshirë konfidencialitetin mjekësor dhe bindjet private.

**Ky është statusi i HOPE:
Përshtatur nga Asambleja e Përgjithshme e HOPE,
Barcelone – 20 Maj 2000**

Ndryshimi i miratuar gjatë Asamblesë së Përgjithshme të HOPE,
Vjenë – 13 maj 2016

(Albanian version of the Charter of HOPE)



www.hospitalteachers.eu